



Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”



Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP




Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës



Hulumtimi mbi Stereotipet Gjinore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë



Projekti KosovaLive Womedia



Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës

Projekt i



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Implementuar nga:



HELVETAS
Swiss Intercooperation

Management
Development
Associates **MDA**

Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”

Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës

Projekti KosovaLive Womedia

Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP

Hulumtimi mbi Stereotipet Gjimore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë

Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës



Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”

Në qershorin që lamë pas u bë inaugurimi i “Meister”-it, një shkollë e re post-sekondare dhe qendër e trajnimit profesional. Qendra, e cila do të përfshijë si modulet mësimore teorike ashtu edhe ato praktike, është mbështetur nga EYE në vazhden e zhvillimit të katër standardeve profesionale të cilat do të aplikohen për zhvillimin

e kurrikulës. EYE gjithashtu i siguroi qendrës pajisje të cilësisë së lartë të cilat do të mundësojnë mësimin praktik përmes pjesëmarrjes aktive. “Meister”-i në kuadër të fushave të studimit do të ofrojë inxhinieri energjetike, hidroteknikë, termoteknikë dhe mekatronikë. Në këtë institucion ku zbatohet të mësuarit në vendin e punës

37 persona janë trajnuar deri më tani; deri në fund të vitit priten të trajnohen edhe 150 të tjerë.

mësimi do të plotësohet me përvojën praktike, ku studentët do të angazhohen nëpër kompani të ndryshme për të pranuar mentorim dhe zhvilluar aftësitë e tyre. Përveç kësaj, pas përfundimit të programit, do të bëhet ndërmjetësimi i studentëve për t’u angazhuar në sektorin privat, duke përfshirë HymeriGroup.

Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”

Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës

Projekti KosovaLive Womedia

Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP

Hulumtimi mbi Stereotipet Gjimore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë

Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës

Nga gjithsej 151 studentë të angazhuar në 64 kompani, 142 prej tyre kanë përfunduar përvojën e punës si pjesë e kurrikulës së AAP.

Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës

Gjatë muajit qershor, EYE grumbulloi akterët kryesorë në sektorin e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) si dhe zyrtarët e Ministrisë së Arsimit për të prezantuar të ardhmen premtuese të pilot-projektit të të mësuarit në vendin e punës (MVP) në Kosovë. MVP është me të vërtetë speciale. Modeli paraqet tri elemente të reja në sistemin dual të arsimit: kompensimin e studentëve nga ana e kompanive, planet e trajnimit që zhvillohen nga shkollat e Arsimit dhe Aftësisit Profesional në bashkëpunim me instruktorët brenda kompanive dhe



trajnimet e instruktorëve brenda kompanive. Një ndër të gjeturat kryesore të këtij pilot-projekti është se bizneseve u nevojitet të japin kontributin e tyre financiar për të realizuar një nivel më të lartë të interesimit dhe angazhimit të studentëve.

Disa të gjetura tjera tregojnë se shkollat AAP të cilat brenda tyre posedojnë qendra të trajnimit kanë implementuar skemën me një përqindje më të lartë suksesi sesa ato të cilat nuk e kanë themeluar atë. Nga gjithsej 151 studentë të angazhuar në 64 kompani, 142 e kanë përfunduar MVP-në.

Rreth 87% të studentëve të

klasës së 12-të të cilët kanë qenë pjesë e skemës MVP iu është ofruar një vend i punës. Për më tepër, rreth 80% të studentëve të klasës së 11-të do të vazhdojnë skemën e tyre MVP në vitin tjetër shkollor nëpër të njejtat kompani.

Si një sistem, MVP ndërlidhë shkollat profesionale vendore me nevojat specifike të industrisë. Të dhënat e lartëpërmendura tregojnë se skema MVP është premtuese dhe si e tillë duhet të vazhdojë, mirëpo duhet të kufizohet në sektorë që kanë nevojë të madhe për fuqi punëtore të kualifikuar dhe gatishmëri për bashkëpunim.

Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”

Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës

Projekti KosovaLive Womedia

Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP

Hulumtimi mbi Stereotipet Gjimore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë

Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës



Projekti KosovaLive Womedia

Projekti Womedia që mbështetet nga EYE ofroi trajnim, mentorim, mësimdhënie, mundësi për zhvillim profesional dhe ndërmjetësim punësimi për gratë e reja të moshës 18-32 vjeçe të të gjitha komuniteteve në Kosovë. Ky projekt ndër të tjerash ka përfshirë ofrimin e trajnimeve për shkrim, produksion, komunikim,

marketing në rrjetet sociale dhe fjalim publik/prezantim. Deri në fund të muajit qershor 2019 në këtë program u regjistruan 85 gra.

Gjithsej 35 vajza kanë përfunduar me sukses punën e tyre praktike duke shkruar një numër të konsiderueshëm prej 87 artikujsh dhe duke përgatitur 23 video.

Deri në fund të muajit qershor 2019, 85 gra u regjistruan në program.

Shtatë vajzave iu është ofruar mundësia që të punojnë me rrogë nëpër projektet tjera të KosovaLive, ndërsa njëra prej tyre është punësuar si mentor në KosovaLive.

Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”


Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës

Projekti KosovaLive Womedia

Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP

Hulumtimi mbi Stereotipet Gjimore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë

Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës



Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP

7 qendra të karrierës u themeluan në 7 shkolla AAP.

Në muajin qershor të këtij viti, EYE mbështeti një trajnim intensiv trejavor për personelin e qendrave të karrierës rreth kompetencave themelore për orientimin në karrierë. Personeli është trajnuar rreth mënyrave se si të shfrytëzohen të dhënat e tregut të punës dhe karrierës në internet për të shqyrtuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të tyre. Shkëmbimi i përvojave dhe njohurive me qendrat e karrierës që kanë më shumë përvojë, si ato në Vushtri dhe

Prishtinë, ndihmuan qendrat e reja që t'u ofrojnë nxënësve të vitit të 12-të trajnime më të mira të shkathtësive të buta. Deri në fund të vitit, EYE do të mbështesë themelimin e tri qendrave tjera të karrierës të vendosura në shkollë në Qendrën e Kompetencës në Malishevë, Shkollën AAP “11 Marsi” në Prizren dhe Shkollën AAP “Shtjefen Gjeqovi” në Prishtinë. Si rezultat i ndryshimit të konceptit në arsimin profesional që ka përfshirë shërbimet e orientimit në karrierë për studentët në qendrat tashmë të themeluara të karrierës që nga viti i kaluar (Gjakovë, Pejë, Ferizaj dhe Kaçanik), rreth 3,218 nxënës përfituan në gjysëmjetorin e parë të vitit 2019, që është gati tri herë më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Përveç nxënësve të AAP, qendrat e karrierës vazhduan mësimdhënien për 3,723 nxënës të klasës së 9-të për marrjen e vendimeve të vetëdijshme rreth profesioneve të ardhshme. Kjo është një rritje prej 65% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. EYE ka mbështetur themelimin e gjithsej 7 qendrave të karrierës në 7 shkolla AAP.

Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”

Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës

Projekti KosovaLive Womedia

Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP

Hulumtimi mbi Stereotipet Gjinore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë

Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës



Hulumtimi mbi Stereotipet Gjinore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë

Në fillim të këtij viti EYE mbështeti Qendrën për Studime Sociale dhe Hulumtim të Qëndrueshëm për publikimin e hulumtimit mbi stereotipet gjinore dhe zgjedhjet e karrierës në Kosovë. Studimi analizoi ndikimin e pabarazisë gjinore në paga dhe perceptimet normative të çështjeve gjinore rreth karrierës “së përshtatshme” të perceptuar nga meshkujt, gratë dhe komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Të gjeturat tregojnë

se vajzat i tejkalojnë djemtë në arsimin fillor. Megjithatë, vajzat janë të prirura të zgjedhin fushat siç janë arsimit dhe psikologjia, që dallojnë nga ato të karrierave të orientuara në shkencë. Studimi zbuloi se familja luan rolin kryesor në përcaktimin e zgjedhjes së karrierës së individit dhe se familjet janë të prirura t’u sugjerojnë vajzave “karriera stereotipike të vajzave”. Për më tepër, së bashku me

Mbledhjet informative u zhvilluan në 7 shkolla fillore

Ministrinë e Arsimit, EYE fasilitoi mbledhjet informative rreth orientimit në karrierë për prindërit e nxënësve të klasës së 9-të në 7 shkollat fillore anembanë Kosovës, me qëllim të vetëdijësimit dhe nxitjes së debatit mbi stereotipet gjinore rreth profesioneve të ndryshme.

Inaugurimi i qendrës së trajnimit “Meister”


Rezultatet dhe Rekomandimet e të Mësuarit në Vend të Punës

Projekti KosovaLive Womedia

Trajnimi i personelit të katër qendrave të karrierës në shkollat AAP

Hulumtimi mbi Stereotipet Gjimore dhe Zgjedhjet e Karrierës në Kosovë

Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës



Akademia jCoders lanson simulatorin e përvojës së punës

Nuk është më një sekret: çfarë punëdhënësit në Kosovë vërtetë dëshirojnë janë shkathtësitë praktike! Tani, përmes mbështetjes së EYE, jCoders janë duke implementuar programin e Simulatorit të Përvojës së Punës (WES). Në muajin shkurt të këtij viti, 2 grupe prej 15 studentëve nga Akademia jCoders dhe Shkolla e Mesme Xhevdet Doda në Prishtinë filluan dizajnimin e

projektit për Raiffeisen Bank Kosovo.

Ky program u ofron studentëve përvojën e zhvillimit të projektit, kryesisht duke punuar nëpër projekte që realizohen në jetën e përditshme, si mjet për të plotësuar mangësitë midis arsimit formal dhe shkathtësive që nevojiten për punësim. WES, si fasilitator i projektit, jo vetëm që ndihmon në zhvillimin e shkathtësive profesionale të

nxënësit, por gjithashtu u ofron të sapodiplomuarve përvojën e tyre të parë të punës. Akademia jCoders tani planifikon të dizajnojë programet WES për kompanitë e ardhshme.

15 nxënës të shkollave të mesme u angazhuan në zhvillimin dhe dizajnin e uebit për të promovuar shkëmbimin e njohurive ndërmjet shteteve nga ana e Raiffeisen Bank Kosovo.